

FRONËZIMI I MITROPOLITIT TË BERATIT, VLORËS DHE KANINËS, HIRËSI ASTIT



Në atmosferë lutjeje, hiri e ngazëllimi shpirtëror u krye sot më 21.11.2024 fronëzimi i Mitropolitit të Beratit, Vlorës dhe Kaninës, Hirësi Astit, në Katedralen e Shën Dhimitrit, në Berat.

Shërbesa e fronëzimit u kryesua nga Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe Gjithë Shqipërisë, Imzot Anastasi, me pjesëmarrjen e anëtarëve të Sinodit të Shenjtë, klerikëve të shumtë nga të gjitha mitropolitë, përfaqësuesve të pushtetit lokal, personaliteteve, përfaqësuesve të komuniteteve fetare lokale dhe qindra besimtarëve shpresëtarë nga i gjithë vendi.

Kryepiskopi Anastas, duke e uruar Mitropolitin e ri për detyrën e tij baritore, shprehu mirënjohjen për përkushtimin e tij për mbi 2 dekada në shërbim të Kishës sonë dhe bindjen se Hirësia do të vazhdojë të përdorë dhuratat e tij të shumta, "...që vepra e tij baritore të jetë gjithnjë vepër bese, mundi i tij të jetë gjithnjë mund dashurie dhe shpresa e tij gjithnjë e lidhur me durimin".

Më tej, edhe Protopresviteri Joan Qako shprehu falënderim dhe mirënjohje për Mitropolitin Asti.

Në fjalën e tij, ndër të tjera, Hirësi Asti u shpreh: "...Do të përpiqem me gjithë shpirtin tim dhe fuqinë time e do të mundohem të ofroj gjithçka që kam dhe gjithçka që kam mësuar, në: Rritjen dhe thellimin në Krishtin, Miqësinë, Shërbimin dhe Dëshminë; objektiva të cilat u na u dhanë qysh herët në fillim nga Kryepiskopi Anastas dhe u bënë busull për jetën tonë më Krishtin.

Të gjitha këto e shumë të tjera janë vulosur në ndërgjegjen time për të jetuar më thellë dashurinë e Perëndisë. Le të jetë dashuria dhe përkushtimi im një përgjigje ndaj himnit "Si do t'ia shpërblejmë Zotit të mirat që na ka bërë?". Perëndia të më ndriçojë, të më fuqizojë e të më denjësojë në vazhdim në dashurinë e Tij si edhe në këtë përgjegjësi baritimi".

I urojmë Mitropolitit Asti hir, dashuri e shenjtëri në krye të Mitropolisë së Shenjtë të Beratit. I denjë!

Shërbesën e plotë mund ta ndiqni në linkun:

<https://www.facebook.com/share/p/15PNPymY4n/>

```
<span data-mce-type="bookmark" style="display: inline-block; width: 0px; overflow: hidden; line-height: 0;" class="mce_SELRES_start"></span>
```

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)